

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief  
State Prosecutor

Kryeprokurori i Shtetit në bazë të nenit 1, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe në bazë të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 6.1.4. të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nxjerr këtë:

### UDHËZIM

#### Lidhur me trajtimin e krimeve të urrejtjes

- I. Koordinatori për trajtimin e krimeve të urrejtjes caktohet me vendim të posaçëm të Kryeprokurorit të Shtetit
- II. Obligohet secila prokurori në departamentet përkatëse të caktoj nga një prokuror që do të merret me rastet e krimeve të urrejtjes.
- III. Obligohet Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe shkrimoret e Prokurorive Themelore për të bërë ndryshimet e nevojshme në regjistrat përkatës me qëllim të identifikimit të rasteve të krimit të urrejtjes.
- IV. Obligohet koordinatori për trajtimin e krimeve të urrejtjes që të përgatis raportet përkatëse statistikore në periudhën 3 mujore.
- V. Obligohet Koordinatori për trajtimin e krimeve të urrejtjes në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe OSBE-në të zhvillojë një program trajnimi me prokurorët e caktuar sipas pikës 2 të këtij dispozitivi.
- VI. Obligohen prokurorët që gjatë gjithë fazës së procedurës penale ti përmbahen kërkesave që rrjedhin nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe në të gjitha rastet penale të kërkojnë nga Gjykata të marrë parasysh rrethanat rënduese kur kanë të bëjnë me krimet e urrejtjes.

### A r s y e t i m

Prokurori i Shtetit është kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale dhe veprave të tjera siç ceken me ligj. Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykimë për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes

kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes shëndetësore, apo pozitës shoqërore.

Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor duhet të veprojë në pajtim me neni 70 paragrafi 2 nën paragrafi 12 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe ti kërkojë gjykatës të merr parasysh si rrethanë rënduese nëse plotësohet ndonjëri nga elementet e nenit të lartcekur: "Nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale".

Krim i urrejtjes konsiderohet çdo vepër penale ndaj një personi fizik ose juridik, i cili është kryer në tërësi ose pjesërisht për shkak të tiparit real ose të perceptuar të një personi që lidhet me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, origjinën etnike, fenë ose bindjen, aftësinë e kufizuar mendore ose trupore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjen politike.

Secili person mund të jetë viktimë e krimit të urrejtjes, megjithëse pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë viktimat më të shpeshta. Krimet e urrejtjes gjithashtu kanë si shënjestër pronat që i përkasin apo që ndërlidhen me një komunitet.

Krimet e urrejtjes kanë disa karakteristika dalluese që prokurorët duhet ti kenë parasysh kur vlerësojnë provat lidhur me këto vepra penale e sidomos deklaratat e viktimave dhe dëshmitarëve. Shumë viktima të krimeve të urrejtjes ngurrojnë të deklarojnë dhe të tregojnë ngjarjen e plotë të viktimizimit të tyre për një sërë arsyesh. Ata shpesh janë anëtarë të komuniteteve të marginalizuara dhe si të tillë, e përjetojnë diskriminim si një pjesë të rregullt të jetës së tyre të përditshme. Prokurorët duhet ta kenë parasysh se për disa viktima ofrimi i zbatimit të ligjit mund të jetë një sfidë në vetvete. Prokurori i rastit gjatë gjithë procedurës penale duhet të argumentojë nëse krimi i urrejtjes ka pasur ndikim të dëmshëm tek i dëmtuari, duke përfshirë dëmin psikik, rrënimin e autoritetit apo çfarëdo dëmi tjetër që viktima e ka pësuar.

Kur prokurori konsideron se një rast mund të jetë i motivuar nga paragjykimet, hapi tjetër është të sigurohet se ka dëshmi të mjaftueshme për ta vërtetuar motivin e paragjyimit dhe nëse nuk ka, duhet të mbledh sa më shumë prova. Nevoja për të


provuar motivin e paragjykimit i dallon krimet e urrejtjes nga vepra e tjera penale. Prokurorët duhet ti vërtetojnë rrethanat si dashjen apo dhe rrethanat tjera të rastit.

Për shkak se krimet e urrejtjes janë krime që bartin një mesazh të caktuar të paragjykimit, kryerësit shpesh nuk i fshehin motivet e tyre, andaj hetimi me vëmendje i këtyre krimeve mund të grumbullojë prova që dëshmojnë motivin e kryerjes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në fjalët e urrejtjes, simbolet, grafitet në pronë, publikimet në internet etj.

Marrë parasysh përkushtimin dhe obligimin ligjor të prokurorit të shtetit për trajtim të barabartë të të gjithëve para ligjit si dhe rëndësinë e mbrojtjes së grupeve të marginalizuara, lëshohet ky udhëzim për shkak të arsyeve të cekura më lart.

Ky udhëzim do të shërbej për trajtimin më efikas të këtyre veprave penale që ndërlidhen me krimet e urrejtjes.

Këtij udhëzimi i bashkëngjitet si shtojcë dokumenti: "Udhëzues praktik - ndjekja e krimeve të urrejtjes", publikuar nga OSBE, ODIHR dhe Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve.



Tu dërgohet:

- Të gjithë kryeprokurorëve;
- Prokurorëve të gjitha prokurorive;
- Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Arkivit;